



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.935/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Faruk Guri kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik LDK, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si i pa rregullt apeli i apeluesit Faruk Guri kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik LDK, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, me numër: ZL.Anr.935/2017, të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017,

A r s y e t i m

Me datën 10.11.2017, PZAP-i ka pranuar apelin e parashtruar nga Faruk Guri kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik LDK, me të cilat pretendon se në Qendrën e Votimit 2524/01R në formularin e kandidatëve nuk ka pasur asnjë votë, ndërsa sipas deklaratës së vëzhguesit ka pasur 2 vota.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së apelit, gjeti se:

Apeli është i pa rregullt

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apelet e parashtruara nga ana e apeluesve të lartëcekur, janë të parregullta, sepse nuk janë të nënshkruara nga parashtruesit e apeleve dhe si të tilla apelet nuk i plotësojnë kriteret e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 10.6, ku përcaktohet se: Apelet duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga parashtruesi i apelit apo në emër të tij nga i autorizuari.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozitat e lartë theksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbështetje të nenit 10.6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.935/2017 më datën 12.11.2017.

**Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani**



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.